



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME, KORÇË

Nr. 45 prot

Korçë më 24.10.2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Drejtuar : Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhezimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të njësisë".

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin :

Mësimdhënës me kohë të pjesëshme, me ngarkesë mësimore 150 ore/vjetore për modulin mësimor me kod; M-10-1070-14.

Mësues i kulturës profesionale lëndët teorike profili mësimor Dizajn Mode (pas të mesëm).

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën Profesionale Shërbime, Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon :

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet te plotesoje Kriteria të posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë Përkatëse niveli Master profesional ose te barazvlefshem me te ne të njëjtën fushë me njerin nga kualifikimet profesionale të ofruesit te AFP-së.
- b) Të ketë të paktën 1 (nje) vit eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

- 1. Dosja e aplikimit , e cila permban dokumentacionin e kerkuar , sipas njoftimit te vendit te lire, duhet te perfshije :
 - a) letër motivimi për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 te ketij udhezimi
 - c) kartën e identitetit,
 - d) diplomën
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
 - g) certifikatë ose dëshmi per nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
 - j) vërtetim nga punëdhënësi I fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të tyre të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
Dokumentat e aplikimit dorezohen ne protokollin e ofruesit te AFP-se brenda dates.....02.11.2023.

TATIANA MERO
DREJTORI I SHKOLLËS

